



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:261647

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06876464

**C-IV.-14-7081**

*Ankuesi:*

**H Gj** nga fshati T, Komuna e Istogut.

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Radusha”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, më datë 06.02.2025, lëshon këtë:

### A K T G J Y K I M

**1.APROVOHET** si e bazuar ankesa e paditësit dhe ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PEJ153-0112 i datës 28 Tetor 2014.

**2.OBLIGOHET** e paditura AKP t’i paguaj ankuesit H Gj në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën nga data 01 janar 2009 deri më datë 30 qershor 2013, shumën prej **4,238.94 €**, ndërsa emër të kamatës ligjore në 10% të shumës së kërkuar, tia paguaj shumën prej 423,90 €,

**3.**Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim me prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

**4.**Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 19 nëntor 2014, ankuesi punëtor i NSH “Radusha” – Istog, ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”), kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PEJ153-0112 i datës 28 Tetor 2014, me të cilin vendim i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4,238.94 euro, për periudhën prej 01 janar 2009 deri më datë 30 qershor 2013. Ankuesi ka

theksuar se i njëjti së bashku me punëtorët e tjerë është kujdesur për objektin, arkivën, mjetet e transportit e të tjera deri më datë 03.10.2013 kur AKP i ka njoftuar për likuidim, me që rast edhe i kanë dorëzuar dokumentacionin administrativ, atë të kontabilitetit etj. Duke shtuar se gjatë kësaj periudhe nuk kanë pranuar paga dhe se kërkesat për paga nga drejtori janë arsyetuar me faktin se të njëjtit kanë paraqitur kërkesë të shkruar dhe gojore pranë AKP-së në Pejë, mirëpo, të njëjtit nuk kanë marrë përgjigje. Ankuesi me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të tij ka bashkangjitur këto prova: Vendimin e kundërshtuar të AL-së, Procesi i pranim dorëzimit të materialit të NSH-së i datës 03 Tetor 2013, Kopjen e librezës së punës.

Gjykata me datë 24 nëntor 2023, ka lëshuar urdhër me të cilin ka kërkuar nga ana e ankuesit që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të tij, të dorëzohen në gjykatë kopja e njoftimit për ndërprerjen e mardhënjes së punës, kopjen e listës së pagave, prova këto që dëshmojnë se NSH-ja ju ka mbetur borxh paga të papaguara, si dhe prova të tjera shtese.

Ankuesi e ka pranuar urdhrin dhe të njëjtit i është përgjigjur me datë 13 dhjetor 2023, ku ka dorëzuar kopjen e librezës së punës, kopjen e kontratës së punës e datës 30.03.2002, Deklaratën e ankuesit e datës 22 Tetor 2013, Kërkesën e parë të NSH-së për kompensimin e 3 pagave të fundit me numër LRP.nr.2021/2013, e datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Kërkesën e dytë të NSH-së për kompensimin për ndërprerjen kolektive të punës me numër LRP.nr.2020/2013, e datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Kërkesën e tretë të NSH-së për kompensimin e pagave të pa paguara pa përfshirë 3 pagat e fundit me numër LRP.nr.2022/2013, e datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Formulari për dorëzimin e kërkesës pranë AKP-së e datës 23 Tetor 2013, Listën e punëtorëve të NSH-së e datës 29 Tetor 2013.

E paditura ka paraqitur mbrojtjen e saj me datë 21 shkurt 2024, me të cilën ka mbetur prapa vendimit të AL-së me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara, duke vlerësuar se kjo e drejtë është parashkruar dhe se i njëjti vendim është i bazuar në ligj dhe se me rastin e vendosjes nuk është shkelur ndonjë dispozitë materiale apo procedurale. Tutje ka shtuar se ankuesi nuk ka treguar se cilin nga nenet e ka shkelur AL me rastin e lëshimit të vendimit.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Radusha” në Istog. Nuk është kontestues as fakti se NSH-ja i ka mbetur paga borxh ankuesit. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. Ashtuqë e paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit, duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati.

Ndërsa në kundërshtim të këtyre pretendimeve ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në:

Kopjen e librezës së punës, Kopjen e kontratës së punës e datës 30.03.2002, Procesin e pranim dorëzimit të materialit të NSH-së i datës 03 Tetor 2013, Deklaratën e ankuesit e datës 22 Tetor 2013, Kërkesën e parë të NSH-së për kompensimin e 3 pagave të fundit me numër LRP.nr.2021/2013 të datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Kërkeswn e dytë të NSH-së për kompensimin për ndërprerjen kolektive të punës me numër LRP.nr.2020/2013, e datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Kërkeswn e tretë të NSH-së për kompensimin e pagave të pa paguara pa përfshir 3 pagat e fundit me numër LRP.nr.2022/2013, e datës 03 Tetor 2013, e vërtetuar tek noteri A G, Formulari për dorëzimin e kërkesës pranë AKP-së e datës 23 Tetor 2013, Listën e punëtorëve të NSH-së e datës 29 Tetor 2013.

Nga Kopja e Librezës së punës ne emër të ankuesit, vërtetohet fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së “Radusha” prej datës 28 nëntor 1999 deri më datë 03 Tetor 2013.

Nga Kontrata e Punës e datës 30 mars 2002 vërtetohet fakti se NSH-ja dhe H Gj tani ankuesi kishin lidhur marrdhënjë punë për pozitën kamarier.

Nga kërkesa e parë e NSH-së për kompensimin e 3 pagave të fundit të pa paguara me numër LRP.nr 2021/2013 e datës 3 Tetor 2013, vërtetohet fakti se ishte bërë kërkesë edhe për kompensimin e 3 pagave për ankuesin në shumë prej 316,02 €.

Nga kërkesa e dytë e NSH-së për kompensimin e ndërprerjes kolektive të marrdhënjes së punë me numër LRP.nr.2020/2013, e datës 03 Tetor 2013, vërtetohet faktin se ishte bërë kërkesë për kompensim edhe për ankuesin në shumë prej 316,02 €.

Nga kërkesa e tretë e NSH-së për kompensimin e pagave të pa paguara me numër LRP.nr.2022/2013, e datës 3 Tetor 2013 vërtetohet faktin se shuma e mbetur borxh nga NSH "Radusha" ndaj ankuesi arrin shumën prej 4.238,94 €.

Nga formulari për parashtrim të kërkesave vërtetohet fakti se ankuesi kishte paraqitur kërkesë me datë 23 Tetor 2013, për kompensim të shumës prej 4,238.94 €.

Nga procesi i pranimit dorëzimit i datës 03 Tetor 2013, vërtetohet fakti se ankuesi kishte marr pjesë me rastin e pranimit dorëzimit të materialit të NSH-së, ku ankuesi është nënshkruar i këtij procesi tek palët dorëzuese.

Provat e tjera të prezentuara nga pala gjykata i ka administruar mirëpo, nuk i ka arsyetuar për faktin se nuk kanë qene relevante për vendimarrjen në këtë çështje juridike civile.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e paraqitura nga ana e ankuesit dhe në bazë të të njëjtave arriti në përfundimin se shuma e kërkuar për kompensimin e pagave të pa paguara mbulohet në bazë të listës së pagave të pa paguara të cilën e ka paraqitur paditësi si provë.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës lidhur me pretendimin se ka arritur afati i parashkrimit të të drejtës së kërkesës për kompensimin e pagave, mirëpo pretendimi i tillë nuk është i saktë, pasi në parashkrim nuk përfshihet periudha e kërkuar dhe se shuma e kërkuar për kompensim për paga të mbetura borxh arrihet në bazë të listës së pagave të mbetura borxh që NSH-ja i ka kërkuar për kompensim nga AKP-ja .

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi H Gj, kishte ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se e njëjta i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 423,90 euro në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

## **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme “Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bart shpenzimet e veta”. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore me datë 06 nëntor 2023.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a  
**Hajrije Shala**